



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I KOMUNIKIMEVE ELEKTRONIKE DHE POSTARE
-Këshilli Drejtues-

V E N D I M

Nr.1353, datë 06. 08. 2010

Per

“Fillimin e procedimit administrativ, per zgjidhjen e mosmarreveshjes mbi perfundimin e afatit te vlefshmerise dhe rinovimin e marreveshjes se interkoneksionit midis Albtelcom sh.a dhe Albanian Mobile Communications sh.a.”

Këshilli Drejtues (KD) i Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare (AKEP), i përbërë nga:

1. Z. Piro	Xhixho	Kryetar
2. Znj. Alketa	Mukavelati	Anëtar
3. Z. Benon	Paloka	Anëtar
4. Z. Ibsen	Elezi	Anëtar
5. Znj. Zamira	Nurçe	Anëtar

dhe sekretare Znj. Anilda Mulgeci, në mbledhjen e datës 06.08.2010, sipas procedurës së përcaktuar në ligjin nr. 9918 datë 19.05.2008 “Për Komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë”, ligjin nr. 8480, datë 27. 05.1999 “Për funksionimin e organeve kolegjiale të administratës shtetërore dhe enteve publike” dhe Rregullores së Brendshme të AKEP-it, shqyrtoi çështjen me objekt:

Zgjidhje mosmarreveshje mbi perfundimin e afatit te vlefshmerise dhe rinovimin e marreveshjes se interkoneksionit midis Albtelcom sh.a dhe Albanian Mobile Communications sh.a

BAZA LIGJORE:

1. Neni 120, i Ligjit nr. 9918, datë 19.05.2008 “Për Komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë”;
2. Nenet 66-104 te ligjit nr. 8485, date 12.05.1999 “Kodi i Procedurave Administrative” (K.Pr.A);
3. Rregullore “Per procedurat e zgjidhjes se mosmarreveshjeve”, miratuar me Vendim te Keshillit Drejtues te AKEP nr. 1296, date 11.06.2010;

4. Rregullore “Per Aksesin dhe Interkoneksionin”, miratuar me VKD nr. 416, date 07.12.2007, e ndryshuar me VKD nr. 1300, date 14.06.2010;
5. Pika 17 e nenit 21 të Rregullores së Brendëshme të AKEP (Rregullorja e Brendshme), miratuar me Vendim të Këshillit Drejtues të ERT-së, nr. 170, datë 24.04.2004, e ndryshuar dhe në fuqi sipas pikës 3 të nenit 138 të ligjit nr. 9918.

K Ë S H I L L I D R E J T U E S:

Nga shqyrtimi i materialit shkresor, diskutimeve në mbledhje mbi çështjen, si dhe duke iu referuar bazës ligjore të sipërcituar.

V Ë R E N :

1. Albtelcom, me shkresen nr. 2480/2 prot, date 30.06.2010 i është drejtuar AKEP me kërkesen, për nderhyrjen e menjeherëshme në zgjidhjen e situatës, për të detyruar AMC të nënshkruajë Marreveshjen e Interkoneksionit me Albtelcom në zbatim, duke informuar AKEP mbi procesin e negociatave, për rinovimin e marreveshjes së interkoneksionit me AMC, si më poshtë vijon:
 - a. Fillimi i negociatave në Mars 2010, për të cilën është kërkuar një takim midis paleve;
 - b. Takimi i mbajtur më 11.03.2010, në prezencën e menaxhereve më të lartë të të dy kompanive, ku midis të tjerash, përveç fillimit të bisedimeve për rinovimin e marreveshjes së interkoneksionit, Albtelcom diskutoi disa çështje lidhur me zbatimin e marreveshjes në fuqi;
 - c. Për takimin e mbajtur më 11.03.2010, AMC u angazhua ndaj Albtelcom se do të kishte një përgjigje për të gjitha çështjet e parashtruara;
 - d. Në vijim të komunikimeve dhe korrespondencave sipërmarresit kanë shkëmbyer në formë elektronike draft-amendimet për amendimin e marreveshjes së interkoneksionit ekzistuese;
 - e. Albtelcom ka shprehur pranimin për propozimin e AMC për shtyrjen e afatit të vlefshmerisë së marreveshjes ekzistuese, por ka insistuar që shtyrja e këtij afati, të mos jetë ekuivalente me lidhjen e një marreveshje të re dhe të jetë në përputhje me kuadrin ligjor e rregullator në zbatim të Vendimit të Këshillit Drejtues nr. 1210 date 31.03.2010;
 - f. Kërkesë e Albtelcom për të bërë disa saktësime në marreveshjen ekzistuese me AMC;
 - g. Shkresa nr. 2892/1 prot, date 21.06.2010 e Albtelcom drejtuar AMC, propozim “Për amendimin e Marreveshjes së Interkoneksionit”.
2. Albtelcom refuzon pranimin e afatit 1 vjeçar të këtij amendimi, pasi parashikon se nga AKEP pritet të miratohen dhe konkludohen dokumente të rëndësishme rregullatore të cilat kanë impakt të rëndësishëm në marreveshjen midis paleve, siç janë:
 - a. Analiza e tregjeve perkatëse;

- b. Vendimet per kostot e sherbimeve;
 - c. Perditesimet ne RIO-t respektive;
 - d. Afati i perfundimit te periudhes se rregullimit deri me 31.08.2010, i percaktuar nga VKM nr. 854 date 18.06.2008.
3. Palet pas dates 30.06.2010, kur perfundon afati i vlefshmerise se marreveshjes se interkoneksionit midis sipermarresve mbeten pa nje rregullim perkates ne kushte dhe terma me force ligjore dhe kontraktuale per ofrimin e sherbimeve te interkoneksionit dhe njekohesisht cdo e drejte dhe detyrim qe rrjedh nga kuadri ligjor dhe rregulator nuk mund te behet i kerkueshem dhe i zbatueshem nga palet;
 4. Pavaresisht negociatave ndermjet tyre, palet kane mosmarreveshje ne lidhje me nenshkrimin e marreveshjes se re te interkoneksionit si rezultat i mosperfundimit te negociatave per nenshkrimin e amendamentit te MI ekzistuese nga AMC.
 5. Albtelecom kete mosmarreveshje e mbeshtet ne nenin 50 dhe 60 te ligjit nr. 9918, date 19.05.2008 "Per komunikimet elektronike ne Republiken e Shqiperise" dhe Rregullores "Per procedurat e zgjidhjes se mosmarreveshjeve", miratuar me Vendim te Keshillit Drejtues te AKEP nr. 1296, date 11.06.2010.

P Ë R K Ë T O A R S Y E:

Duke marrë në konsideratë rëndësinë e zgjidhjes se mosmarreveshjes mbi perfundimin e afatit te vlefshmerise dhe rinovimin e marreveshjes se interkoneksionit midis Albtelecom sh.a dhe Albanian Mobile Communications sh.a, bazuar në pikën 1 të nenin 114, dhe pikën 1 të nenit 115 të ligjit nr. 9918 date 19.05.2008 "Për Komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë", neni 7 i Rregullores "Per procedurat e zgjidhjes se mosmarreveshjeve" si dhe pika 17 e nenit 21 të Rregullores së Brendshme te AKEP, e ndryshuar.

V E N D O S I:

1. Të filloje procedimin administrativ, per zgjidhje mosmarreveshje mbi perfundimin e afatit te vlefshmerise dhe rinovimin e marreveshjes se interkoneksionit midis Albtelecom sh.a dhe Albanian Mobile Communications sh.a
2. Palet deri me date 24.08.2010, te depozitojne ne AKEP pretendimet me shkrim, prova dhe fakte mbi perpjekjet nga te dyja palet per zgjidhjen e mosmarreveshjes;
3. Te ngrihet komisioni per zgjidhjen e mosmarreveshjeve me anetare:

Altin Rrapaj	Kryetar
Jonida Gjika	Anetar
Edlira Vatnikaj	Anetar
Ded Jakaj	Anetar
Florida Cela	Anetar

4. Të njoftohen palët e interesuara për këtë vendim;
5. Ky vendim të publikohet në faqen e internetit www.akep.al

Ky Vendim hyn në fuqi në datën e miratimit të tij.

K R Y E T A R I
Piro XHIXHO

ANËTARET E KËSHILLIT DREJTUES:

1. **Alketa MUKAVELATI**
2. **Benon PALOKA**
3. **Ibsen ELEZI**
4. **Zamira NURÇE**